



USHTRIA



Viti i 72-të i botimit Nr. 34 (827630)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 30 Gusht 2019

ATASHEU USHTARAK I REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË



Nenkolonel Hans-Peter Wamsler përfundon misionin e tij në Shqipëri

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka priti më 23 gusht në një takim kortezie ish atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë në vendin tonë, nenkolonel Hans-Peter Wamsler me rastin e përfundimit të misionit të tij në Shqipëri. Nenkolonel Hans-Peter Wamsler

shoqërohej nga atasheu i ri që merr detyrën, nenkolonel Dirk Weber. Kolonel Zarka vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë midis Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Gjermanisë, si dhe falenderoi atasheun ushtarak për kontributin e tij gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri. Nga ana e tij nenkolonel... >>> faqe 2

Ligji "Për mbrojtjen civile"

Buxheti i mbrojtjes civile në institucionet qendrore



>>> faqe 6-7

Operacioni "Sea Guardian"

Anija "Lissus" fillon stërvitjen për operacionin në detin Egje

Stërvitja paraprake përfshin veç lëndëve profesionale edhe njohjen e gjuhës angleze >>> faqe 3



102 vatra zjarri në 24 ditë

FA izolojnë vatrën e zjarrit në Shëngjin

Forcat e Armatosura në bashkëpunim me strukturat e tjera shtetërore si zjarrfikësit e Bashkisë Lezhë dhe të Portit të Shëngjinit, forcat e Policisë dhe ndihmën e banorëve kanë izoluar me 24 gusht vatrën e zjarrit të rënë në kurorën e gjelbër të qytetës turistike. Pas dy ditësh punë në terren, 9 mjete zjarrfikëse dhe rreth 200 forca nga këto...



>>> faqe 3

Gjeneral brigade Kollçaku

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak është një aset kombëtar

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Zarka, zhvilloi një vizitë në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak (SHMU). Gjatë këtij takimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, u njoh nga drejtuesit e SHMU me misionin, detyrat, strukturën, veprimtarinë, problematikat dhe sfidat e këtij shërbimi. Më tej ai vizitoi edhe ambientet e punës dhe u njoh...

>>> faqe 5



NATO-RUSI

Kanalet politike dhe ushtarake mbeten të hapura

>>> faqe 9

SPECIALE

Shtypi ushtarak në rrugëtimin e tij

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ >>> faqe 4

FORCA AJRORE

Mbështetje për përpunimin logjistik të avionit amerikan Tip C-130J

>>> faqe 5

Atasheu ushtarak i Republikës Federale të Gjermanisë

Nënkolonel Hans-Peter Wamsler përfundon misionin e tij në Shqipëri

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka priti atasheun ushtarak të gjermanisë nënkolonel Hans-Peter Wamsler i cili mbaroi misionin dhe atasheun e ri që merr detyrën, nënkolonel Dirk Weber

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Editson Zarka priti më 23 gusht në një takim kortezie ish atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë në vendin tonë, nënkolonel Hans-Peter Wamsler me rastin e përfundimit të misionit të tij në Shqipëri. Nënkolonel Hans-Peter Wamsler shoqërohej nga atasheu i ri që merr detyrën, nënkolonel Dirk Weber.

Kolonel Zarka vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë midis Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Gjermanisë, si dhe falenderoi atasheun ushtarak për kontributin e tij gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri.

Nga ana e tij nënkolonel Wamsler, falenderoi zëvendëskomandantin e Forcës Ajrore për mbështetjen e dhënë në kryerjen e detyrës së tij në Shqipëri, duke vlerësuar si mjaft pozitiv bashkëpunimin dhe shprehur vlerësime të larta për efektivitetin e kësaj Force.

Gjatë takimit nga dy palët u shpreh bindja e forcimit të marrëdhënieve ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, duke zgjeruar më tej fushat e bashkëpunimit.

Në përfundim të takimit Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, i uroi atasheut të ri ushtarak, nënkolonel Dirk Weber, suksese në detyrën e re, si dhe shprehur gatishmërinë për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes për realizimin me sukses të misionit të tij në vendin tonë.



ATASHE TË USHTARAKË NË KOMANDËN E FORCËS DETARE



Bashkëpunim me gjermanët për arsimimin e detarëve tanë

Atashe të ushtarakë gjerman, nënkolonel Hans Peter Wamsler, i cili plotësoi qëndrimin në Shqipëri dhe nënkolonel Dirk Weber, i sapoemëruar në detyrën e atasheut ushtarak në Shqipëri vizituan më 23 gusht Komandën e Forcës Detare. Ushtarakët gjermanë u pritën në një takim nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i Rangut I Artur Meçollari. Gjatë takimit u diskutuan çështje të bashkëpunimit midis flotës luftarake gjermane me Forcën tonë Detare, në fushën e arsimimit të detarëve tanë, vizitave portuale, bashkëpunimin dy palësh në kuadër të operacionit "Sea Guardian", si dhe zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta.

gjeneral brigade Sallaku.

Nga ana e tij, nënkolonel Hans Peter Wamsler vlerësoi arritjet që Komanda Mbështetëse ka bërë gjatë kësaj periudhe, ai vlerësoi bashkëpunimin me këtë komandë dhe theksoi se ndihet krenar që shërbeu në një vend me një histori të madhe dhe të çmuar sikurse është Shqipëria. Ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe shpresoj që nënkolonel Orink Weber të bëjë më shumë për forcimin dhe intensifikimin e këtij bashkëpunimi sidomos në fushën logjistike.

Më tej, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Sallaku uroi atasheun e ri ushtarak të Republikës së Gjermanisë në Shqipëri, nënkolonel Dirk Weber, për marrjen e detyrës së re dhe garanto bashkëpunim të vazhdueshëm në fushën e logjistikës.

Nënkolonel Wamsler vlerëson arritjet e Komandës Mbështetëse

Atasheu ushtarak i Republikës Gjermane, nënkolonel Hans Peter Wamsler, i cili plotësoi misionin e tij në këtë detyrë në vendin tonë, zhvilloi një vizitë më 23 gusht në Komandën Mbështetëse. Në këtë vizitë nënkolonel Wamsler shoqërohej nga zëvendësuesi i tij në këtë detyrë, atasheu i ri ushtarak i Republikës së Gjermanisë në Shqipëri, nënkolonel Dirk Weber.

Në mjediset e Komandës Mbështetëse u zhvillua një takim kortezie nga komandanti, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku. Gjeneral brigade Sallaku duke ju shprehur mirëseardhjen në këtë komandë, ju uroi atyre njëkohësisht suksese në detyrat e radhës si për atasheun në ikje nënkolonel Wamsler ashtu edhe atasheut të ri të Republikës së Gjermanisë në vendin tonë nënkolonel Weber.

Gjatë takimit ushtarakët e dy vendeve evidentuan fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcat e Armatosura Gjermane,



që nga arsimimi e trajnimi ushtarakë shqiptarë në fushën e logjistikës, mbështetjen konkrete me materiale didaktike, teknike dhe deri tek stërvitjet e përbashkëta midis dy vendeve të zhvilluara ndër vite.

Komandanti i Komandës

Mbështetëse vlerësoi kontributin e çmuar të nënkolonel Hans Peter Wamsler, gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, për mbështetjen që ka dhënë në përgjithësi për Forcat tona të Armatosura dhe veçanërisht për Komandën Mbështetëse. "Nënkolo-

nel Wamsler do të mbetet një mik i veçantë i vendit tonë dhe i Komandës Mbështetëse, për kontributin e shkëlqyer që ai ka dhënë në forcimin e partneritetit strategjik e sidomos në fushën logjistike midis Republikës së Gjermanisë dhe Shqipërisë". - theksoi

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Gazetarë:
Saimir ALIJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Operacioni "Sea Guardian"

Anija "Lissus" fillon stërvitjen për operacionin në detin Egje

Stërvitja paraprake përfshin veç lëndëve profesionale edhe njohjen e gjuhës angleze

Forca Detare ditën e martë më 27 gusht ka filluar stërvitjen paraprake me ekuipazhin e ri të anijes "Lissus", e cila do të marrë pjesë në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje. Misionin i anijes "Lissus", në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje, do të jetë parandalimi i trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore dhe shpëtimi i jetës së njerëzve.

Trajnimi i ekuipazhit të anijes "Lissus", do të realizohet sipas një programi të veçantë. Me këtë rast zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut I Artur Meçollari, dha udhëzime të vecanta për çështjet që do trajtohen në përgatitjen e këtij ekuipazhi, ku përparësi do t'i jepet kuadrit të ri oficer, nënoficer, me qëllim ripërtëritjen e detarëve profesionistë në anije.

"Stërvitja duhet të jetë me ngarkesë të plotë, ditën dhe natën, për të qenë të gatshëm për mision, sepse nuk ka më kohë", - theksoi kapiten i rangut I Meçollari.

Ekuipazhi është përzgjedhur mbas një testimi profesional, fizik e shëndetësor dhe në përgatitjen e tyre do përfshihet veç lëndëve profesionale dhe njohja e gjuhës angleze.

Roli i efektivave dhe anijes shqiptare në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje është raportimi i trafikimit të migrantëve në zonën operationale dhe ndërhyrja duke ofruar ndihmë në rastet kur konstatohet se jetët njerë-



zore janë në rrezik. Informacioni i siguruar gjatë patrullimit së bashku me anijet greke, holandeze, turke dhe britanike është shkëmbyer në kohë reale me rojet bregdetare greke dhe turke, si dhe misionin e Bashkimit

European "Frontex" në detin Egje, në interes të parandalimit të fluksit të refugjatëve dhe migrantëve.

Anijet e Forcës sonë Detare patrullojnë prej 2 vitesh e gjysmë në detin Egje ku kanë parandaluar



dhe shpëtuar mijëra emigrantë të paligjshëm. Vetem para pak ditësh anija "Oriku" gjatë patrullimit në detin Egje ka shpëtuar 36 shtetas afganë. Anijet shqiptare janë pjesë e grupit të gatshëm të anijeve të NATO, Standing

NATO Maritime Group 2 (SNMG2), në detin Egje. Operacioni i NATO-s, "Sea Guardian" ka filluar në detin Egje në nëntor 2016, si një operacion të sigurisë detare i cili kryen një gamë të gjerë detyrash.

U REGJISTRUAN 102 VATRA ZJARRI NË 24 DITË

FA izolojnë vatrën e zjarrit në Shëngjin

Nga fillimi i muajit gusht deri më datë 24 janë regjistruar në mbarë vendin 102 vatra zjarri, ku u angazhuan mbi 110 mjete dhe rreth 1000 forca

Forcat e Armatosura në bashkëpunim me strukturat e tjera shtetërore si zjarrfikësit e Bashkisë Lezhë dhe të Portit të Shëngjinit, forcat e Policisë dhe ndihmën e banorëve kanë izoluar me 24 gusht vatrën e zjarrit të rënë në kurorën e gjelbër të qytezës turistike.

Pas dy ditësh punë në terren, 9 mjete zjarrfikëse dhe rreth 200 forca nga këto struktura bënë të mundur eliminimin e rrezikut për qendrën e banuar dhe aktualisht asnjë banesë nuk u kërcënua nga flakët. Terreni tejet i thyer pamundësoi ndërhyrjen e mjeteve zjarrfikëse, ndërkohë që temperaturat e larta vështirësuan ndërhyrjen e trupave në terren. Situata në vatrën e zjarrit në Shëngjin është përmirësuar ndjeshëm edhe falë reshjeve të shiut gjatë mbrëmjes së dyte, ndërkohë që gjithë strukturat e angazhuara mbeten në terren deri në shuarjen e plotë të flakëve. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile informon se gjatë këtij muaji, deri më datë



24 janë regjistruar në mbarë vendin 102 vatra zjarri, ku janë angazhuar mbi 110 mjete, dhe rreth 1000 forca,

ku përfshihen zjarrfikësit, Forcat e Armatosura, punonjës të bashkive, por edhe vullnetarë.

Gruoi EOD-Batalioni i Xhenios

Asgjësohet shtimja e kalibrit 75 mm në Kaninë, Vlorë

Një grup EOD përfundoi me sukses me 27 gusht operacionin për asgjësimin e një shtimje luftarake të kalibrit 75mm. Mbas njoftimit të marrë nga organet e Ministrisë së Brendshme për praninë e një shtimje luftarake, një grup EOD i Batalionit të Xhenios të KM ku morën pjesë gjashtë forca dhe dy mjete ndërmorën operacionin për asgjësimin e këtij municioni të rrezikshëm për jetën e banorëve.

Kjo shtimje u zbulua gjatë kryerjes së punimeve në vendin e quajtur Kaninë qendër, fshati Kaninë, bashkia Vlorë, rreth 10 m nga rruga kryesore. Përfaqësuesit e Policisë së Shtetit fillimisht realizuan rrethimin e zonës së sigurisë dhe shoqëruan grupin EOD deri në përfundimin e operacionit.

Municioni ishte një shtimje e topit 75 mm që mendohet të ketë përfunduar në këtë vend gjatë trazirave të vitit '97. Asgjësimi i shtimjes u bë në vend pasi u vlerësua nga specialistët si e rrezikshme për tu transportuar.

"Xhenierët e FA eliminuan një rrezik real për banorët e Kaninës në Vlorë. Një shtimje topi 75 mm prej vitit të mbrapshtë 1997, gjendej vetëm 10 m nga rruga kryesore. Skuadrës së EOD iu desh ta asgjësonte në vend shtimjen pasi u vlerësua si e rrezikshme për t'u transportuar", shkruan Xhaqka në facebook.





PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Shtypi ushtarak në rrugëtimin e tij

Përpyetje për fillimet e shtypit ushtarak

Përpyetje për nxjerrjen e shtypin ushtarak u bënë që në qeverinë e Ismail Qemal Vlorës, ku u shtypën rregullore dhe u përcaktuan detyra për problemet ushtarake dhe të Forcave të Armatosura. Por pamje më të mirë dhe të organizuar të shtypit ushtarak mori në kohën e monarkisë, kur filloi të shkruhej. Pas shumë përpyetje në maj të vitit 1931 u arrit që të dilte numri i parë i revistës ushtarake “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake”. Kjo ishte e para revistë ushtarake në Shqipëri, gjatë gjithë historisë 19-vjeçare të Ushtrisë Shqiptare. Në faqet e saj zunë vend artikuj të ndryshëm që kishin të bënin për ushtrinë, reformat, organizimin, protagonistët dhe modernizimin e saj. Përpyetje bëheshin dhe në shtypin e ditës, që duhet thënë se ka qenë tepër aktiv për problemet e ushtrisë. Dalja e kësaj reviste u prit mirë, pasi ishte revistë e dedikuar për ushtrinë dhe problemeve të saj, e që dilte për herë të parë në vendin tonë. Misioni i kësaj reviste ishte i natyrshëm që do të pasqyroste, të përhapte dhe pasuronte kulturën ushtarake, në mënyrë të veçantë për kuadrot ushtarake. Revista dilte një herë në muaj dhe u quajt e përkohshme. Ajo kishte një staf që fillonte me drejtorin, redaksinë dhe administratën, të cilat gjendeshin pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Ajo doli me 24 faqe. Në faqet e kësaj reviste përmbledhej dhe buletini zyrtar, ku pasqyroheshin emërime, transferime si dhe komunikime të ndryshme. Në faqet e saj trajtoheshin problem teorike të ushtrisë, teknike dhe ushtarake si dhe ngjarje dhe lajme të huaja. Në revistë vëmendje u kushtohej armëve të ushtrisë. Në numrin e parë zuri vend mesazhi mbretit A. Zogu, ku porosiste që studimi dhe stërvitja të zënë vend tek ushtaraku. Dalja e revistës shënonte një arritje dhe përparim në zhvillimin e ushtrisë.

Drejtor i revistës u caktua Enrico Grazi, që e drejtoi me profesionalizëm deri në vitin 1933. Më pas u emërua nënkolonel Luigi Bonfatti, deri në 1934, për të vazhduar me major Leonardo Motzo, i cili e drejtoi këtë revistë deri në fund të 1937-s. në vitin 1937 stafi i revistës u ndryshua si dhe emri i saj. “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake” arriti deri në 77 numra. Vendin e saj e zuri “Revista ushtarake” që ishte vazhdim i saj, duke pasur drejtor nënkolonel Sami Koka, duke qëndruar deri në vitin 1939. Revista botoi nga numrat 78-91, dilte me 60 faqe, në gjuhën shqipe. Ajo vazhdoi trajtimin e probleme ushtarake si më parë. Me pushtimin fashist italian, u pushua dhe aktiviteti i saj. Në vitin 1938 doli vetëm një numër revista “Fuqitë e Armatosura të 25-vjetorit”.



Revista ishte e ilustruar, me katër faqe, që u botua me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë. Kjo ishte organ i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, me drejtor toger Shaban Strazimiri.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore

Ndërsa në kohën e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri në vitet 1939-1944 dolën gazeta e revista, që ishin në shërbim të fashizmit e nazizmit, si dhe mjaft gazeta antifashiste. Viti 1944 shënon dhe vitin më të bollshëm në botimin e gazetave dhe të revistave ushtarake. Shkurtime po pasqyrojmë disa prej tyre që dolën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Risi e re ishte se dolën dhe mjaft buletine të ndryshme, si nga lëvizja nacional-çlirimtare, nga forcat e tjera si dhe nga forcat fashiste e naziste. Të tillë ishin “Bolletino” (1940), “Buletini i jashtëzakonshëm” (1943-1944), “Buletini i luftës nacional-çlirimtare” (1943-1944), “Buletin i përdyjavshëm”

(1944-1945), etj. Pati dhe revista si “Krahët e Luftës” (1941-1942), kjo e përdyjavshme, që numri i parë daton më 10 qershor 1941. Ishte një organ siç edhe u quajt i “luftëtarëve të ajrit”. Revista botohej deri në 32 faqe, në shqip gjithsej 26 numra, për të përfunduar në fundin e vitit 1942. Drejtor ishte Amedeo Mecozzi dhe shtypej në Romë.

Revista “Liria” doli në Kosovë, duke qenë organ ushtarak i frontit të përbashkët nacional-çlirimtar të Kosovës dhe Metohisë. U botua në dy gjuhë duke trajtuar problem të forcave ushtarake dhe lajme nga lufta. U botua deri nga fundi i vitit 1944. “Mundimi” ishte organ i politik, propagandistik i aviacionit ushtarak britanik e amerikan, botohej e përdyjavshme me dy faqe. Gazeta më tepër ishte informative dhe botohej në Bari, por shpërndohej në Shqipëri. Ajo doli deri në 38 numra, për t’u mbyllur në vjeshtën e vitit 1944. “Përpara në sulm” ishte gazetë politiko-ushtarake e Brigadës

I Sulmuese, me parullën “Në sulm, në zjarr, gjithmonë Brigada e Parë”. Numri i parë doli në shkurt 1944 dhe kishte 26, për të vijuar deri në fundvitin 1945. “Buçitja” ishte organ ushtarako-politik i Brigadës V Sulmuese. Numri i parë doli në prill-maj 1944 dhe u botua në 3 numra. “Ylli çlirimtar”, organ politiko-ushtarak i Divizionit I Sulmues. Doli në qershor 1944 numri i parë vijoi deri në 1945. “Pishtari”, organ politik, ushtarak i Brigadës VIII Sulmuese, me 48 faqe, doli vetëm katër numra dhe trajtonte problemet e luftës. “Zëri i luftëtarit”, organ politik, ushtarak u Brigadës IV Sulmuese, me 20-24 faqe, doli vetëm katër numra. “Horizonti në ndriçim”, organ politik, ushtarak i Brigadës XXII Sulmuese, me 8 faqe, doli vetëm katër numra. “Përpara”, organ politik, ushtarak i Div. II S, me 40 faqe. “Zëri i të riut”, organ politik, ushtarak i Brigadës XII Sulmuese, vijoi edhe në 1945. “Iriqi”, organ satirik, ushtarak i Brigadës VI Sulmuese, me 6 faqe, doli vetëm 2 numra. “Thumbi”, organ satirik ushtarak i Brigadës VIII Sulmuese, me 6 faqe, doli edhe kjo vetëm 2 numra.

Në periudhën moniste

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore edhe në Shqipëri solli ndryshime në formën e organizimit të shtetit. Në pushtet erdhën komunistët, që me luftën e tyre ishin bërë pjesë e Koalicionit të Madh Antifashistë dhe gjithçka e nisën nga e para. Rendi i ri politik, pruri dhe ndryshime në shtypin ushtarak. Që në vitin 1945 dolën dhe organet e para ushtarake. “Luftëtari”, numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë. Gazetë me katër faqe, në të cilën i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe të vendit. Ndërsa gazeta me këtë emër doli rregullisht që nga maji i vitit 1945, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare. Gazeta u bë një armë e fuqishme për edukimin politik, ideologjik e ushtarako-profesional, të të gjithë efektiveve të Forcave të Armatosura.

Kjo gazetë e ka ndryshuar herë pas here formatin, numrin e faqeve, por në thelb mbeti një gazetë ushtarake, më praktika, me probleme të ditës dhe kryesisht ushtarake. Gazeta e pushoi jetën e saj në vitin 1991, në kohën e ndryshimeve të mëdha demokratike që

ndodhën në vend, për të vazhduar më tej me ushtrinë. Revista “10 korriku” u botua në vitin 1947, ku doli dhe numri i parë i saj, organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo trajtonte probleme të edukimit, të jetës artistike e kulturore, të propagandës dhe të përgatitjes teorike dhe ushtarake të ushtarëve. Revista pati jetën më të gjatë dhe vijoi të dalë deri në nëntor 1991. Revista “10 korriku” ishte një revistë ilustrimi dhe më e afërt me ushtarët dhe më e drejtpërdrejtë. Ndërsa numri i 12 i këtij viti, dhjetor 1991, doli me emrin “Ushtria dhe koha”. “Revista ushtarake” doli në vitin 1948, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Revista trajtonte probleme teorike ushtarake, fjalime politike, tema dhe biseda për edukimin komunist, tema ndërkombëtare, të miqësisë me Bashkimin Sovjetik, tema historike etj. “Revista ushtarake politike” kishte si mision kryesor trajtimin e problemeve të përgatitjes politike të ushtarëve dhe oficerëve. Kësaj reviste ju shtua fjala “politike”. Prej vitit 1954 deri në vitin 1967 kjo revistë mori emrin “Revista ushtarake politike” (1954-1967). Trajtoheshin probleme në rrafshin politik, në edukimin komunist, në forcimin e ushtrisë dhe të kufijve, dhe mbi të gjitha shërbente si udhëzues për përgatitjen politike të ushtrisë shqiptare. “Revista politike ushtarake” doli në vitin 1967, pas heqjes së gradave në ushtri dhe rivendosi së komisarëve dhe të komiteteve të partisë në ushtri. Me zbatimin e reformave të marra nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuesit e revistës menduan që të ishte e përnuajshme, duke i ndryshuar emrin e mëparshëm.

Duke bërë si të thuash një rokadë të vogël mes dy mbiemrave revista nga ushtarake politike do të kalonte në politike ushtarake. Kështu në radhë të parë ishte politika, pastaj ushtria, përgatitja fizike e teorike e ushtrisë shqiptare. Revista trajtonte probleme teorike që kishte të bënte me nivelin e lartë të kuadrove ushtarake dhe politikë si komisarë dhe sekretarë të byrove e të komiteteve të partisë. “Për mbrojtjen e atdheut” nisi veprimtarinë e saj në vitin 1975, pas “shpartallimit të grupeve puçiste” në ushtri, dënimin e ministrit dhe gjithë stafit të lartë ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, revista mori këtë emër. Revista e mëparshme funksionin e saj politik nuk e kishte luajtur sa duhet dhe “armiku e kishte bërë punën e vet sabotuese” në faqet e saj. Ndaj dhe drejtuesit e rinj ndërruan emrin e revistës teorike, politike, luftarake, ushtarake.

Nga viti 1975 deri në vitin 1991, kur pushoi jetën e vet, kjo revistë, kishte emrin “Për mbrojtjen e atdheut”. Në thelb revista trajtonte po ato probleme dhe mbeti një propaganduse e pastër organeve të partisë për edukimin politiko-ushtarak të kuadrove të lartë. Pas viti 1991, revista mori një emër të ri “Mbrojtja”, emër me të cilin botohet aktualisht.

Forca Ajrore në stërvitjen “Joint Combined Exchange Training”-JCET

Forca Ajrore në kuadër të realizimit të një prej detyrave të misionit të saj si “Host Nation Support” kreu procedurat mbështetëse për përpunimin logjistik për avionin amerikan Tip C-130J, që u ul në Rinas, për tërheqjen e bazës materiale, e cila u përdor në kuadër të stërvitjes Joint Combined Exchange Training-JCET me palën amerikane. Stërvitja JCET me palën amerikane u zhvillua në vendin tonë në periudhën 29 korrik deri më 5 gusht 2019. Bashkëpunimi me forcat ushtarake amerikane është rritur dukshëm në kuadër të stërvitjeve të përbashkëta, si dhe projekteve të bashkëpunimit dypalësh.

Stërvitja “Joint Combined Exchange Training”-JCET ose “Programet e Trajnimit të Përbashkët të Kombinuar të Shkëmbimit”-JCET janë ushtrime të krijuara për të siguruar mundësi trajnimi për Forcat Speciale Amerikane duke zhvilluar ushtrime

Mbështetje për përpunimin logjistik të avionit amerikan Tip C-130J

trainimi në vendet ku forcat mund të duhet të veprojnë një ditë, si dhe të sigurojnë mundësi trajnimi për forcat e armatosura të vendeve pritëse. Në mënyrë tipike, çdo program JCET përfshin një personel prej 10–40 efektiv të forcave speciale amerikane, megjithëse ndonjëherë mund të përfshihen deri në 100. Kongresi i Shteteve të Bashkuara lejoi përdorimin e fondeve nga buxheti ushtarak që të përdoren në trajnime jashtë shtetit siç janë JCET-s në 1991, me kusht që Sekretari i Mbrojtjes të paraqesë në Kongres çdo vit një raport mbi aktivitetet e trajnimit jashtë shtetit.

Programet JCET u zgjeruan në 1988 në Belgjikë, Danimarkë, Gjermani Perëndimore dhe Itali.

Nga 30 maj deri më 30 qershor 2006, një program JCET u krye nga ushtria amerikane që përfshinte Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë. Kursi përfshinte klasa mbi “udhëheqjen dhe planifikimin, teknikat e shënjimit të pushkëve dhe shpimet, operacionin e afërt të çerekut dhe operacionet ushtarake në mjedise urbane, taktikat e njëjësive të vogla, procedurat themelore individuale të udhëheqjes së trupave dhe aftësitë kolektive të luftimit”.



Batalioni i II-të i Këmbësorisë (b2k)



84 efektivë dhurojnë gjak për të shpëtuar jetë

Në kuadër të fushatës së dhurimit vullnetar të gjakut, që ka filluar prej disa ditësh në Forcën Tokësore, efektivat e Batalionit II të Këmbësorisë (b2k) i janë bashkuar sërish kësaj fushate me 85 efektivë. Batalionit II të Këmbësorisë edhe një herë tregon se është batalion elitar i FA, duke qëndruar gjithmonë në krah të popullsisë civile.

Në këtë nismë efektivat e b2k nxjerrin në pah humanizmin e tyre duke dhuruar gjak për të shpëtuar jetë. Dhurimi vullnetar i gjakut nga grupi i sotëm i b2k, vjen vetëm disa ditë pas dhurimit vullnetar të gjakut nga Batalioni Komando.

Fushata e dhurimit të gjakut, do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, me reparte të tjera të Forcës Tokësore. Fushata kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në kujdesin e mjekëve të qendrës shëndetësore. “Djersën, gjakun dhe gjithçka për njerëzit dhe vendin tonë!” – tha nënkolonel Nazmi Hoxha, komandanti i b2k.

GJENERAL BRIGADE BARDHYL KOLLÇAKU

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak është një aset kombëtar

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Zarka, zhvilloi një vizitë në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak (SHMU). Gjatë këtij takimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, u njoh nga drejtuesit e SHMU me misionin, detyrat, strukturën, veprimtarinë, problematikat dhe sfidat e këtij shërbimi. Më tej ai vizitoi edhe ambientet e punës dhe u njoh edhe me personelin dhe detyrat që ata kryejnë.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, pasi shprehu kënaqësinë për vizitën në SHMU, falenderoi personelin e SHMU për përkushtimin, profesionalizmin në realizimin e detyrës. Ai vuri theksin në rëndësinë e këtij shërbimi si një aset kombëtar, për të sjellë në kohë reale dhe sa më të sak-



të parashikimin e motit jo vetëm për nevojat e Forcave të Armatosura, por për të gjitha institucionet shtetërore

dhe qytetarët e thjeshtë. Vizita u mbyll me një foto të përbashkët me personelin e kësaj strukture.

Operacioni



Vihet nën kontroll zjarri, kthehet normaliteti në Pustec

Përgjatë gjithë martë deri në orën 22:00 të mbrëmjes, është ndërmarrë operacioni për neutralizimin dhe shuarjen e flakëve të vatrave të zjarrit në Cerje të bashkisë Pustec, në prefekturën e Korçës. Për kryerjen e këtij operacioni u angazhuan 21 forca të DMR Korçë dhe dy mjete përfshi këtu dhe një zjarrfikëse. Për arsye të terrenit të vështirë dhe të pakalueshëm nga automjetet për shuarjen e zjarrit u punua me mjete të thjeshta pune si kazma, lopata apo mjete të tjera rrethore. Fillimisht u bë neutralizimi i vatrave të zjarrit në afërsi të qendrës së banuar duke mënjeluar rrezikun për banorët dhe pasurinë e tyre dhe më pas në gjithë sipërfaqen prej 15 hektarësh ku ishte përhapur zjarri. Operacioni përfundoi në orët e vona të mbrëmjes duke bërë të mundur vënien nën kontroll të zjarreve dhe kthimin në normalitet të zonës.

Ligji "Për mbrojtjen civile"

Buxheti i mbrojtjes civile në institucionet qendrore

Ligji "Për mbrojtjen civile" është firmosur nga Presidenti i Republikës, Ilir Meta me Dekret Nr. 11241, datë 30.7.2019 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.113, datë 1 gusht 2019. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



(Vijon nga numri i kaluar)

**KREU IX
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE PRIVATE DHE TË ORGANIZATAVE JO FITIMPRURËSE**

NENI 60

Të drejtat e subjekteve private dhe të organizatave jofitimprurëse

Subjektet private kanë të drejtë të informohen në mënyrë të vjuar përrisqet nga fatkeqësitë, si dhe për masat e nevojshme dhe ato të marra për menaxhimin e tyre. Çdo subjekt privat, vendas apo i huaj, ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e tij dhe të pronës nga strukturat e mbrojtjes civile në rastet e fatkeqësive. Shoqatat dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, krahas të drejtës së informimit për fatkeqësitë, kanë të drejtë të kryejnë studime për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; të paraqesin konkluzione pranë institucioneve dhe strukturave të mbrojtjes civile, në nivelin qendror dhe vendor, mbi studimet e kryera nga ato mbi zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; të jenë partnerë në zbatimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë Shoqatat dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile mund të marrin pjesë vullnetarisht në zbatimin e masave dhe të aktiviteteve për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, sikurse në përballimin e fatkeqësisë, pas miratimit të autoritetit përgjegjës.

NENI 61

Detyrimet e subjekteve private

Subjektet private, vendase dhe të huaja, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë këto detyra: të hartojnë dhe të përditësojnë plane të brendshme për emergjencat civile, të harmonizuar me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë, apo bashkive dhe qarkut apo qarqeve, si edhe rregullore të brendshme, sipas rrezikshmërisë së proceseve teknologjike, kur ato përdorin, prodhojnë dhe magazinonë materiale të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre, gaze energjetike, si dhe kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme; të sigurojnë me shpenzimet e tyre pajisjet e alarmit për punonjësit e tyre dhe për komunitetin, si dhe të garantojnë funksionimin e tyre, kur ato kanë mbi 20 punëmarrës; të informojnë punonjësit e tyre për rreziqet e mundshme, t'u sigurojnë atyre kushte e mundësi për realizimin e mbrojtjes së tyre; të njoftojnë dhe të japin alarmin për komunitetin e rrezikuar dhe të njoftojnë te numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, numrat e tjerë të emergjencave, apo edhe autoritetet e tjera, sipas ligjit, në rastet e fatkeqësive; të sigurojnë trajnimin për punonjësit e tyre, për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive, kur ato kanë mbi 20 punëmarrës; të bashkëpunojnë me strukturat e mbrojtjes civile dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre; të aktivizojnë shërbimin në përgjigje të situatës së krijuar nga fatkeqësia në këtë zonë dhe në ndihmë të subjekteve të tjera; të vendosin në dispozicion të

strukturave të mbrojtjes civile automjete, mjete, mjedise private, objekte, pajisje dhe burime energjetike, sipas kërkesës së strukturave të mbrojtjes civile; të vendosin pa pagesë, në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe të njësitë të vetëqeverisjes vendore, të dhënat që ato disponojnë dhe që janë të nevojshme për përgatitjen e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe planit për emergjencat civile. Subjektet që zhvillojnë veprimtari, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën "a", të pikës të këtij neni, duhet të: bashkëpunojnë në informimin e publikut dhe mbajtjen e këtij informacioni të përditësuar, në veçanti atij të zonave në afërsi të subjektit dhe në dhënien e këtij informacioni autoritetit përgjegjës për përgatitjen e planeve të jashtme të emergjencës; krijojnë ekupe të mbrojtjes civile, të pajisura me mjete dhe të trajnuara në përputhje me këtë ligj. Kur ato ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullësor kombëtar, janë të detyruara të mbrojnë këto sipërfaqe nga zjarret, duke hartuar dhe përditësuar plane për mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë apo bashkive dhe prefekturës apo prefekturave, si edhe rregullore të brendshme lidhur me këtë çështje.

**KREU X
ARSIMIMI DHE TRAJNIMI**

NENI 62

Arsimimi

Arsimimi në nivelin parauniversitar

sitar siguron njohuri mbi mbrojtjen dhe parandalimin e fatkeqësive, në përputhje me profilin e tyre. Ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, siguron përfshirjen në programet mësimore të njohurive për mbrojtjen civile.

NENI 63

Kryerja e trajnimeve

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programit dhe moduleve të miratuara më parë nga ministri për këtë qëllim. Nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, struktura përkatëse të mbrojtjes civile të ministrive, prefektit të qarkut dhe të bashkive, përmirësojnë vazhdimisht aftësitë e tyre profesionale nëpërmjet trajnimeve, të financuara nga ana e tyre ose donatorëve të ndryshëm.

**KREU XI
FINANCIMI**

NENI 64

Buxheti i mbrojtjes civile në institucionet qendrore

Buxheti i mbrojtjes civile të institucioneve qendrore përbëhet nga buxheti i shtetit; buxheti vjetor i çdo ministrie, i parashikuar si zë më vete, për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile. Burimet e financimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile përbëhen nga: buxheti i shtetit; donacione

të ndryshme; burime të tjera që i lejon ligji. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile pranon, administron dhe përdor donacione financiare dhe burime të tjera financiare për mbrojtjen civile, në bazë të legjislacionit në fuqi.

NENI 65

Buxheti i bashkive

Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë: nga të ardhurat e veta vendore; nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet; si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj. Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 66

Fondi i solidaritetit

AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile sipas parashikimeve të këtij ligji. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik. Fondi i krijuar sipas këtij neni, mund t'u transferohet njësitë të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

**KREU XII
INSPEKTIMI DHE
KUNDËRVAJTJET
ADMINISTRATIVE**

NENI 67

Inspektimi

Inspektimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji për mbrojtjen civile për institucionet dhe strukturat shtetërore dhe subjektet private kryhet nga inspektorët e AKMC-së, sipas dispozitave ligjore në fuqi për inspektimin Gjatë inspektimeve, inspektorët duhet të shqyrtojnë në veçanti: zbatimin e masave për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen ndaj fatkeqësive dhe rimëkëmbjen e pasojave të tyre; miratimin dhe përditësimin e dokumentit të

strategjisë për zvogëlimin riskut nga fatkeqësitë, dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile; planifikimin e fondeve nga institucionet publike dhe strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese nga fatkeqësitë në objektet dhe infrastrukturën e tyre, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore; organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në fushën e veprimtarisë së tyre; krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në fushën e përgjegjësisë së tyre dhe shkëmbimin e informacioneve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; zbatimin e detyrimeve ligjore, si edhe udhëzimeve të ndryshme të dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

NENI 68

Kundërvajtjet administrative

Shkelja e njëres prej dispozitave të parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "d", të pikës 1, dhe shkronjat "a" e "b", të pikës 2, të nenit 61, të këtij ligji, nga subjektet private, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000-100 000 lekë. Shkelja e njëres prej dispozitave të parashikuara në pikën 8, të nenit 14; shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "ë", të pikës 2, të nenit 22; shkronjat "a", "c", "ç", "d", "ë", "f", "gj" dhe "h", të pikës 2, të nenit 28; shkronjat "a", "c", "d", "dh", "e", "ë", "g" dhe "gj", të nenit 30; pikat 3 dhe 4, të nenit 42; shkronja "b", e pikës 2, të nenit 43; pikat 2, 3 dhe 5, të nenit 49; pikat 1 dhe 2, të nenit 51; shkronja "ç", e nenit 58, të këtij ligji, nga titullarët e institucioneve shtetërore apo subjektet private, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) -500 000 (pesëqind mijë) lekë.

NENI 69

Konstatimi i shkeljeve

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 68, konstatohet nga inspektori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e mbahet procesverbal përkatës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për inspektimin. Mënyra e konstatimit dhe e shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative realizohen në bazë të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative, ndërkohë që formati i procesverbalit të konstatimit të shkeljes

Fillesat e tij Batalioni i Mbështetjes së SHPFA i njohur vite më parë si batalioni i Sigurimit është krijuar në vitin 1955 me kompaninë e Ruajtjes dhe Ceremonialit të SHPFA. Në vitin 1965 u suprimua si kompani dhe u organizua në nivel më të lartë atë të batalionit, me urdhër

Urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 317 date 24.09.1965 "Mbi organizimin e Batalionit të Sigurimit të MM", në përbërje të batalionit futet Kavaleria e Ushtrisë me elementët përbërës të asaj kohe. Në vitin 1998 në strukturën e batalionit të mbështetjes krijohet Grupi I i Sistem-Vëzhgimit e lajmërimit elektronik (Seksioni i Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA). Në vitin 2003 Orkestra Frymore e FA është përfshirë në strukturën e batalionit.

Ashtu si më parë dhe sot batalioni i mbështetjes luan një rol kyç për mirëfunksionimin e sistemit të sigurisë, transportit dhe mbështetjes me shërbime. Kompania Ceremoniale ka në përbërje Truprojën e Nderit e cila përgatitet për të mbështetur ceremonitë shtetërore dhe ushtarake, evente dhe homazhe. Orkestra Frymore e FA ka në përbërjen e saj bandën Frymore e cila ashtu si Truproja e Nderit mbështet çdo ceremoni duke u bërë një kartvizitë e denjë për përfaqësimin sa me dinjitoz të Forcave tona të Armatosura.

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (bmSHPFA) është strukturë organizative në vartësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Batalionit të Mbështetjes ka për mision sigurimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e personelit, infrastrukturës së MM, SHPFA dhe strukturave ushtarake/institucioneve të vendosura në garnizonin "Skënderbej", krijimi i kushteve të përshtatshme për punë dhe jetesë në vendkomandën e kohës paqes të SHPFA-së, sigurimi i elementëve të ceremonialit gjatë pritjeve zyrtare që organizohen nga MM/SHPFA dhe institucionet e tjera shtetërore, sigurimi i mbështetjes me transport të MM-së, SHPFA-së, delegacioneve të huaja dhe vizitorëve si dhe krijon kushtet për pushimin e personelit të FA-së në SHPU-ve.

Detyrat kryesore janë: Zbatimi i masave të sigurisë/ruajtjes në gar-



1965-2019

54 vite nga formimi i Batalionit të Mbështetjes të FA

Batalioni i Mbështetjes luan një rol kyç për mirëfunksionimin e sistemit të sigurisë, transportit dhe mbështetjes me shërbime

nizionin "Skënderbej", SHPU dhe objektet në ruajtje. Mbështetja me shërbime dhe personel për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës ushtarake në garnizonin "Skënderbej", SHPU, repart dhe objektet në ruajtje. Mbështetja e ceremonialit shtetëror, ushtarak dhe mortor. Mbështetja me transport të MM/SHPFA e delegacioneve dhe aktivitete të tjera të zhvilluar në FA.. Mbështetja shëndetësore në garnizonin "Skënderbej" dhe jashtë tij. Krijimi i kushteve për akomodim dhe pushim të ushtarakëve aktivë, rezervë dhe në pension në SHPU.

Struktura

Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA është strukturë organizative në vartësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm me përbërje:

Komandanti dhe Shtabi, komandanti i bm SHPFA përgjigjet për gjendjen, menaxhimin e personelit, stërvitjen dhe përgatitjen luftarake,



mobilizimin, gatishmërinë luftarake dhe çdo veprimtari tjetër që ka për mision repartit që ai drejton, sipas kompetencave që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. Kompania e Mbështetjes me Shërbime, përgjigjet për sigurimin e kushteve të përshtatshme për punë dhe jetesë në vendkomandën e kohës së paqes dhe atë të veçantë të SHPFA. Daljet në fushim, në rast stërvitjesh dhe emergjencash civile. Mbështetjen me transport dhe material.

Kompania e Ruajtjes, siguron ruajtjen e mbrojtjen e personelit, infrastrukturës dhe instalimeve ushtarake në garnizonin "Skënderbej", repart, OFFA, Kompanisë së Transportit ish - parkut të auto-veturave si dhe SHPU: Uji i Ftohtë Vlorë, Jalë, Pogradec, Durrës.

Kompania e Ceremonialit, siguron elementët e ceremonialit për zhvillimin e të gjitha veprimtarive ceremoniale shtetërore, ushtarake, kombëtare e ndërkombëtare të organizuara nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i FA dhe Protokolli i Shtetit, bazuar në Ceremonialin e zyrtar të Republikës së Shqipërisë dhe në Ceremonialin Ushtarak. Kompania e Mbështetjes me Transport, siguron mbështetjen me transport të MM/SHPFA, delegacioneve të huaja, aktivitetet e ndryshme të FA-së, brenda dhe jashtë vendit. Orkestra Frymore e FA, OFFA siguron organizimin dhe zhvillimin e të gjitha veprimtarive ceremoniale shtetërore, ushtarake e kulturore artistike, të organizuara nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i FA dhe Protokolli i Shtetit, bazuar në Ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë dhe në Ceremonialin Ushtarak.

Seksioni i Sigurisë, përgjigjet për sigurimin e personelit, infrastrukturës, instalimeve ushtarake në garnizonin "Skënderbej", parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara, sigurimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të FA. Qendra Shëndetësore, ofron mbështetje shëndetësore në Garnizonin "Skënderbej" nëpërmjet Rol-1 duke identifikuar dhe mbështetur kapacitetet nga pika e dëmtimit apo e sëmundjes, nëpërmjet evakuimit, deri tek trajtimi i specifikuar dhe eventualisht tek trajtimi definitiv tek specialisti. Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve, siguron kushte normale gjatë gjithë vitit për akomodimin dhe pushimin e ushtarakëve aktive, në rezerve dhe pension si dhe civilëve që shërbejnë në Forcat e Armatosura.

miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së.

NENI 70-71

Ankimi dhe ekzekutimi i vendimit

Ankimi administrativ kundër gjorbës së vendosur për shkëljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe të legjislacionit në fuqi për inspektimin, te Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Përbërja e komisionit dhe procedura e shqyrtimit miratohen me urdhër të ministrit. Kundërvendimit të komisionit mund të bëhet ankim, brenda 30 ditëve, në gjykatën kompetente për çështjet administrative, në

përputhje me legjislacionin në fuqi. Ekzekutimi i gjorbave, në zbatim të këtij ligji, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 72

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që: brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 9, pika 3, nenit 10, pika 1, nenit 14, pika 4, neni 22, pika 4, neni 23, pikat 2 dhe 6, shkronja "d", nenit 38, pika 3, nenit 40, pika 3, nenit 47, pika 3, nenit 48, pika 2, nenit 50, pika 4, dhe nenit 51, pika 3,

të këtij ligji. brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 20, pika 3, nenit 25, pika 3, nenit 26, pika 2, nenit 41, pika 6, dhe nenit 65, pika 2, të këtij ligji. brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 13, pika 7, dhe 23, pika 7, të këtij ligji. Ngarkohet ministri përgjegjës për mbrojtjen civile që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 23, pika 9, dhe 70, pika 2, të këtij ligji. Ngarkohet prefektët e qarqeve që, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, pika 5, 28, pika 2, shkronja "gj" dhe 29, pika 3, të këtij ligji. Ngarkohet këshillat bashkiakë që, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij

ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, 14, pika 6 dhe 30, shkronja "a", të këtij ligji. Ngarkohet kryetarët e bashkive që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 29, pika 3, të këtij li gj.

NENI 73-74-75

Dispozita kalimtare, shfuqizime dhe hyrja në fuqi

Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile shndërrohet në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile do të vazhdojë të funksionojë, sipas strukturës ekzistuese, deri në miratimin e organizimit dhe të funksionimit të

